



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nr. 799

U D H Ë Z I M

18.01.2021

Nr. 2, Datë 18. 01. 2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.31, DATË 26.12.2013 “PËR EMETIMIN  
NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,  
TË OBLIGACIONEVE NË FORMË REGJISTRIMI” TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe neneve 5 dhe 20 të Ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë,

**U D H Ë Z O N :**

Në udhëzimin nr.31, datë 26.12.2013, “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

**Neni 1**

Në nenin 12, pikat 2 dhe 3 riformulohen si më poshtë:

2. Në varësi të nevojave të huamarrjes dhe kostos së saj, Ministria mund të ndryshojë ose të anultojë ofertën e shpallur. Në rastet kur shuma e kërkuar nga tregu është më e madhe ose e barabartë me ofertën e shpallur, Ministria mund të devijojë nga oferta e shpallur me maksimumin +/- 15%. Në rastet kur shuma e kërkuar nga tregu është më e vogël se oferta e shpallur, devijimi mund të jetë edhe më i lartë sesa -15% e ofertës së shpallur; në këtë rast MFE ka të drejtën të ulë shumën e pranuar në ankand deri tek shuma apo kërkesa ku fillon të zhvillohet “fat tail” (diferenca ndërmjet yield-it cut-off dhe yield-it mesatar të ponderuar).

3. Vendimi për devijimin do të mbështetet në cilësinë e kërkesave, jo në nivelin e *yield*-eve, duke synuar që *yield*-i maksimal i pranuar të jetë kufiri i fundit në shpërndarjen normale të serisë së *yield*-eve të kërkuara.

**Neni 2**

Ky udhëzim hyn në fuqi pas Botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

Anila DENAJ

